



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1756 Prot.

Tiranë, më 07.11.2022

VENDIM QARKULLUES

Nr. 91, datë 07.11.2022

**PËR MIRATIMIN E RIALOKIMIT TË KUOTAVE PËR PROGRAMET E STUDIMIT
TË CIKLIT TË DYTË NË FSHL DHE FVFR**

Në mbështetje të nenit 69 të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, kërkesës së Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR) me Nr.1742 Prot, dt.07.11.2022 ”Kërkesë për rialokim të kuotave të studimit në Ciklin e Dytë të studimeve “Master Profesional” dhe “Master Shkencor” pranë FVFR”, të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (FSHL) me Nr.1744 Prot, datë 07.11.2022 “Propozim për rialokimin e kuotave të paplotësuara në programin e Ciklit të Dytë të studimeve Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor” dhe në “Shkenca Sportive” për vitin akademik 2022-2023, Senati me Vendim Qarkullues të datës 07.11.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit të **13 kuotave** të lira nga kategoritë e tjera në Programin e Studimit Master Shkencor “**Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti**”, të rialokohen në zërin **Program i Dytë studimi**.
2. Miratimin e kalimit të **25 kuotave** të lira nga kategoritë e tjera në Programin e Studimit Master Profesional në “**Menaxhim në Sport dhe Turizëm**”, të rialokohen në zërin **Program i Dytë studimi**.
3. Miratimin e kalimit të **50 kuotave** të lira nga kategoritë e tjera në Programin e Studimit Master Profesional në “**Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi**”, të rialokohen në zërin **Program i Dytë studimi**.
4. Miratimin e kalimit të **8 kuotave** të lira nga kategoritë e tjera në Programin e Studimit Master i Shkencave në “**Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor**”, të rialokohen në zërin **Shqiptarë Brenda Vendit**, si dhe **1 kuote** e lirë nga kategoria “të huaj” të rialokohet në zërin “**transferim studimesh**”.

5. Miratimin e kalimit të **13 kuotave** të lira nga kategoritë e tjera në Programin e Studimit Master i Shkencave në “**Shkencat Sportive**”, të rialokohen në zërin **Program i Dytë studimi**
6. Ky Vendim i përcillet për zbatim Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Sektorit të Sekretarisë Mësimore Digjitale dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademike Shkencore për publikim.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA



PROF.DR. ADRIATIK META

PROF.DR. DHIMITRAO SKËNDERI

PROF.DR. DHURATA BOZO

PROF.DR. FATOS GJATA

PROF.ASC. ARBEN KAÇURRI

PROF.ASC. FERDINAND MARA

PROF.ASC. ROBERT ÇITOZI

PROF.ASC. JUEL JARANI

PROF.ASC. BASHKIM DELIA

DR. ELTON SPAHIU

AMBER URSI